

Procesverbal - Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Ristrukturim dhe monitorim I venies ne zbatim te strukture organizative te shoqerise Ujesjelles Kanalizime Tiranë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Sherbime te konsulences per menaxhimin e burimeve njerezore 79414000-9.

Vlera e fondit limit: 9.383.333 (nente milion e treqind e tetedhjetë e tre mije e treqind e tridhjetë e tre) Lekë, pa TVSH.

Mbështetur në planin e biznesit të shoqërisë UKT sh.a. si dhe në projekt buxhetin me Nr.8069 Prot., datë 05.05.2026 miratuar me vendim të Asamblesë së Aksionerëve.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 përkatësisht në vlerën : 187.666,66 (njqind e tetedhjetë e shtate mije e gjashtëqind e gjashtedhjetë e gjashtë presje gjashtedhjetë e gjashtë) leke.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomiko-financiar

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros

minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 43, pika 1, pika 2 c) neni 55 pika 4, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të deklarojë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit se ka shlyer të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore në të gjitha adresat ku operatori ekonomik ka ushtruar apo ushtron aktivitetin sipas të dhënave përkatëse të QKB-së, për kështet e maturuara për vitin 2026, sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomike, çdo anëtar i grupit të BOE duhet të deklarojë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Bazuar në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2025-2026 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.5 Kapaciteti teknik:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate. Operatori ekonomik duhet gjithashtu të paraqesë dëshmi për realizimin e të paktën 1 kontrate me organizata/kompani/struktura të mëdha komplekse me jo më pak se 100 punonjës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara nga organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas legjilacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, shoqëruar me listëpagesën e muajit të fundit ose deklaratë të lëshuar nga organizata/kompani/struktura të mëdha komplekse me jo më pak se 100 punonjës me të cilën është realizuar kontrata ku të specifikohet numri i punonjësve dhe shërbimi i realizuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 ”Kerkesat per kualifikim”, te Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”..”ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, ne vecanti, mund te kerkojne qe operatoret ekonomike te kene nje nivel te mjaftueshem pervoje qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontrata e zbatuara ne te shkuaren”dhe nenit 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Per kontrata e mallrave dhe sherbimeve vlera totale e kerkuar duhet te jete ne nje vlere jo me te madhe se 20 % te vleres se perlllogaritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates””.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marre ne konsiderate vleren e fondit limit te sherbimit te kerkuar objekt procedure prokurimi, eshte menduar se vlera e kerkuar qe OE ofertues te kete realizuar kontrata te ngjashme, te jete afer limitit maksimal te lejuar dhe ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

Certifikatën ISO 9001:2015 (ose ekuivalente) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë

ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimit të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht për periudhën Janar 2026 – Qershor 2026 jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës, nga të cilët

- të paktën 3 (tre) konsulentë për kualifikimet e personelit, të certifikuar për përdorimin e matjeve psikometrike për vlerësimin e individëve dhe ekipeve.
- të paktën 1 (një) ekspert të certifikuar në Programimin e Neuro Linguistikës NLP (Neuro Linguistic Programming).

Për të vërtetuar plotësimin e kësaj pikë ofertuesi duhet të paraqesë:

- Çertifikatat përkatëse të vlefshme për 3 (tre) konsulentë për kualifikimet e personelit dhe për 1 (një) ekspert NLP.
- Kontratë pune të vlefshme për 3 (tre) konsulentë për kualifikimet e personelit dhe për 1 (një) ekspert NLP.
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të periudhën Janar 2026 – Qershor 2026

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e

dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për shërbimet që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

Argumentimi teknik

Objekti i kësaj procedure nuk konsiston vetëm në hartimin e një strukture të re organizative, por përfshin një proces të plotë analize organizative, vlerësimi të roleve dhe përgjegjësi, analizë të kompetencave të stafit, zhvillim të profileve të punës, menaxhim të ndryshimit organizativ dhe mbështetje gjatë fazës së implementimit të strukturës së re.

Për këtë arsye është e domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë një ekip të mjaftueshëm multidisiplinar, me jo më pak se 15 punonjës, i cili garanton realizimin paralel të analizave, intervistave, fokus-grupeve, punës në terren, përpunimit të të dhënave, hartimit të dokumentacionit dhe mbështetjes së Autoritetit Kontraktor gjatë gjithë periudhës së kontratës. Numri i kërkuar i personelit është në përpjesëtim me kompleksitetin e projektit dhe afatin e realizimit të tij.

Kërkesa për të paktën 3 (tre) konsulentë të certifikuar për përdorimin e matjeve psikometrike është e nevojshme pasi procesi i riorganizimit kërkon vlerësimin objektiv të kompetencave profesionale, aftësive individuale, potencialit drejtues, sjelljes organizative dhe përshtatshmërisë së punonjësve me funksionet ekzistuese dhe ato të propozuara. Instrumentet psikometrike përbëjnë metodologji të njohura ndërkombëtarisht për analizën e kapitalit njerëzor dhe ndihmojnë në marrjen e vendimeve të bazuara në të dhëna, duke reduktuar subjektivizmin gjatë procesit të ristrukturimit. Kërkesa për tre specialistë justifikohet nga numri i madh i punonjësve që duhet të analizohen dhe nevoja për zhvillimin paralel të procesit të vlerësimit në disa njësi organizative.

Kërkesa për të paktën 1 (një) ekspert të certifikuar në Neuro Linguistic Programming (NLP) është e lidhur me fazën e menaxhimit të ndryshimit organizativ dhe implementimit të strukturës së re. Riorganizimi institucional shoqërohet me procese komunikimi, menaxhim të rezistencës ndaj ndryshimit, zhvillim të aftësive drejtuese, motivim të stafit dhe facilitim të bashkëpunimit ndërmjet ekipeve. Njohuritë dhe metodologjitë e NLP-së kontribuojnë në përmirësimin e komunikimit organizativ, lehtësimin e proceseve të ndryshimit dhe mbështetjen e drejtuesve dhe punonjësve gjatë implementimit të strukturës së re organizative.

Paraqitja e certifikatave përkatëse, kontratave të punës dhe listëpagesave për periudhën **Janar 2026 – Qershor 2026** kërkohet për të provuar jo vetëm kualifikimin profesional të personelit, por edhe disponueshmërinë reale të këtij stafi si pjesë e operatorit ekonomik në momentin e zhvillimit të procedurës. Kjo i jep Autoritetit Kontraktor garanci se operatori ekonomik disponon burime njerëzore të mjaftueshme dhe të qëndrueshme për realizimin e kontratës, duke shmangur angazhimin formal të ekspertëve vetëm për efekt kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi mbi specifikimet teknike

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me qëllim garantimin e përzgjedhjes së një operatori ekonomik që disponon kapacitetet profesionale, metodologjinë dhe ekspertizën e nevojshme për realizimin me sukses të objektit të kontratës.

Objekti i kësaj procedure nuk konsiston në ofrimin e një shërbimi standard konsulence, por në realizimin e një procesi të plotë të analizës organizative, riorganizimit dhe mbështetjes së implementimit të strukturës organizative të UKT sh.a., një shoqëri me kompleksitet të lartë organizativ, teknik dhe operacional, me 26 njësi organizative dhe rreth 1,347 punonjës, e cila ushtron funksione kritike në ofrimin e shërbimit publik të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Për këtë arsye, specifikimet teknike janë ndërtuar në mënyrë që të garantojnë realizimin e një analize të plotë dhe objektive të organizatës, duke adresuar jo vetëm strukturën formale, por edhe mënyrën reale të funksionimit të saj.

Specifikimet teknike kërkojnë që konsulenti të analizojë dokumentacionin ekzistues, organigramën, ndarjen e funksioneve, përshkrimet e roleve, proceset e punës, linjat e raportimit dhe ndërveprimin ndërmjet njësisë organizative, me qëllim identifikimin e mbivendosjeve funksionale, boshllëqeve organizative, niveleve të panevojshme hierarkike dhe elementeve që ndikojnë në eficiencën operationale të institucionit. Ky proces është i domosdoshëm për të siguruar që struktura e propozuar të mbështetet mbi evidenca reale dhe jo mbi vlerësime teorike.

Po ashtu, është kërkuar zhvillimi i konsultimeve me drejtuesit dhe strukturat përgjegjëse të UKT, pasi procesi i riorganizimit organizativ kërkon mbledhjen e informacionit praktik mbi mënyrën e funksionimit të organizatës, sfidat ekzistuese dhe prioritetet strategjike të institucionit. Përfshirja e këtyre konsultimeve siguron që rekomandimet përfundimtare të jenë të realizueshme dhe të përshtatura me nevojat konkrete të Autoritetit Kontraktor.

Specifikimet teknike parashikojnë gjithashtu hartimin e alternativave të ndryshme organizative dhe përzgjedhjen e modelit më të përshtatshëm, shoqëruar me organigramën përfundimtare, matricën e përgjegjësisë, planin e implementimit, planin e komunikimit dhe manualin e zbatimit.

Këto dokumente janë të domosdoshme për të garantuar që rezultati i kontratës të mos kufizohet në një raport teorik, por të përbëjë një instrument praktik dhe të zbatueshëm nga strukturat drejtuese të UKT gjatë procesit të implementimit të strukturës së re organizative.

Përcaktimi i fazave të projektit dhe i produkteve (deliverables) për secilën fazë është bërë me qëllim monitorimin e progresit të kontratës, verifikimin periodik të cilësisë së shërbimit dhe garantimin e realizimit të objektivave në afatet e përcaktuara. Dorëzimi në format të editueshëm dhe PDF, së bashku me procesin e shqyrtimit dhe reflektimit të komenteve të Autoritetit Kontraktor, siguron kontroll efektiv mbi cilësinë e çdo produkti të dorëzuar dhe mundëson përshtatjen e tij me kërkesat institucionale.

Specifikimet teknike janë hartuar në respektim të parimeve të proporcionalitetit, konkurrencës dhe mosdiskriminimit. Ato nuk favorizojnë një operator ekonomik të caktuar, por përcaktojnë kërkesa minimale profesionale dhe metodologjike të nevojshme për realizimin e objektivit të kontratës, duke garantuar që operatori fitues të jetë në gjendje të analizojë organizatën, të hartojë strukturën e re organizative, të përgatisë dokumentacionin përkatës dhe të mbështesë Autoritetin Kontraktor gjatë fazës së implementimit, në përputhje me standardet profesionale të konsulencës organizative.

Njesia e prokurimit